

**16.03.2021  
Ora 17:25**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Iljaz Jashar Shehu si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, në Zonën Zgjedhore Qarku Lezhë”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**      **PS, LSI, I.Shehu (Kandidat i Pavarur)**

**Z.I.Celibashi:** Mirëmbërëma dhe ndjesë për fillimin me vonesë të seancës! Atëherë, në rend të ditës kemi këto çështje: projektvendim për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Iljaz Jashar Shehu si kandidat për deputet, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021; projektvendimin për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Kreshnik Luan Merxhani, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021; pika e tretë e rendit të ditës është projektvendimi për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Boiken Xhelal Abazi, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021; pika e katërt është projektvendim për miratimin e listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 prill 2021; pika e pestë projektvendim për miratimin e

**Zbardhi materialin audio  
Romina Kokoshi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021; pika e gjashtë, projektvendim për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021; pika e shtatë është projektudhëzimi për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave; kemi projektvendimin pika tetë për një shtesë në Vendimin nr.39, datë 18.12.2020, për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të organizatës KRIIK, për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021; pika e nëntë ka të bëjë me projektvendimin për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të misionit të ODIHR, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021; pika e dhjetë ka të bëjë me projektvendimin për miratimin e gazetarëve të Radio-Televizionit të Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021; pika e njëmbëdhjetë projektvendimi për miratimin e gazetarëve të televizionit ABC News, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021; pika e dymbëdhjetë është projektvendimi që ka të bëjë me miratimin e gazetarëve të televizionit “SYRI TV” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Atëhere fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës! Fjala e sekretarit të KQZ-së për të relatuar mbi projekaktin!

**Z.Y.Merkaj:** Referuar nenit 69, pika 1, të Kodit Zgjedhor, një grup zgjedhësish të një zone zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për atë zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 80, datë 15.02.2021, ka regjistruar Komitetin Nismëtar, i cili do të organizojë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse e z. Iljaz Jashar Shehu si kandidat për deputet, i propozuar nga zgjedhësit, për zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në datën 12.02.2021, Komiteti Nismëtar ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin audio  
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.16.03.2021*

Zgjedhjeve, nënshkrimet mbështetëse të 1350 zgjedhësve të cilët shprehen se janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhore të Zonës Zgjedhore Qarku Lezhë. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës. Referuar nenit 69 pika 3, përcakton se komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetjen për kandidim, të një numri zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 përqind e zgjedhësve të zonës zgjedhore, por jo më shumë se 3000 zgjedhës. Referuar ekstraktit të fundit të listës së zgjedhësve, rezulton se Qarku Lezhë ka 175713 zgjedhës. Sipas përcaktimeve të nenit 69 të Kodit Zgjedhor, numri i zgjedhësve që i korrespondon minimal për 1 përqind të listës 175713 është 1758 zgjedhës. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka verifikuar nënshkrimet e zgjedhësve dhe ka rezultuar se janë dorëzuar gjithsej 3400 nënshkrime të plotësuara sipas modelit 06. Referuar nenit 71, pika 3 të Kodit Zgjedhor, është bërë verifikimi i dokumentacionit duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 5 përqind të zgjedhësve nga lista e mbështetësve. Numri i zgjedhësve të verifikuar është 91 zgjedhës. Në përfundim nga verifikimi i nënshkrimeve, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të pa rregullta, është më i madh se numri minimal i kërkuar nga neni 70, pika 3 e Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 138 të vitit 2015, të ligjit për Dekriminalizimin, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, bëhet për çdo kandidat për deputet. Kandidati për deputet z. Iljaz Shehu, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër rendor 118, numër unik, në datën 05.03.2021. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se ka deklaruar, ka qenë i arrestuar në vitin 2019, në Komisaratin e Policisë Tiranë, ku është liruar pas 72 orësh, gjithashtu është marrë edhe masë shtrënguese, detyrim për t'u paraqitur pranë Policisë Gjyqësore, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga zyra e

*Zbardhi materialin audio*

*Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.16.03.2021*

Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet z. Iljaz Shehu, ku Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, pas verifikimit të gjendjes gjyqësore, ka kthyer përgjigje, se rezulton i padënuar, pra është i padënuar nga gjykatat shqiptare. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Në këto kushte, referuar nenit 12 të ligjit numër 138, të vitit 2015, të ligjit mbi dekriminalizimin, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionet e ardhura nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, për z. Iljaz Shehu, nuk përbëjnë kusht për refuzimin dhe regjistrimin e tij si kandidat për deputet. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, regjistrimin e kandidatit për deputet z. Iljaz Shehu, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësues të partive politike? Për diskutuar në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Ose përfaqësues të Komitetit Nismëtar për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit? Ka ndonjëri diskutim? Dakord, faleminderit. Mirë, atëherë bazuar në atë çfarë u relatua në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës si dhe neni 19 pika 1 shkronja n dhe 2, neni 69,71,72,73, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe udhëzimi numër 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

1. Të regjistroj z. Iljaz Jashar Shehu si kandidat për deputet, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.143**

*Zbardhi materialin audio*

*Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

**16.03.2021  
Ora 17:33**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Kreshnik Luan Merxhani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, në Zonën Zgjedhore Qarku Gjirokastrë”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:                      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:                      PS, LSI, K.Merxhani (Kandidat i Pavarur)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës!

**Z.Y.Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 63, datë 11.02.2021, ka regjistruar Komitetin Nismëtar, i cili do të organizojë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për paraqitjen e z.Kreshnik Luan Merxhani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit, për Zonën Zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në datën 08.03.2021, Komiteti Nismëtar ka paraqitur nënshkrimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të mbështetësve të 1289 zgjedhësve. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dokumentacioni përkatës. Referuar ekstraktit më të fundit të listës zgjedhore, Qarku Gjirokastrë ka 123341 zgjedhës dhe sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 69, të Kodit Zgjedhor, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1

*Zbardhi materialin audio  
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

përqind të listës së 123341 zgjedhësish, është 1233 zgjedhës. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka verifikuar listën shumemërore, nënshkrimet e zgjedhësve në listën mbështetëse dhe rezulton se janë plotësuar sipas modelit 06. Në bazë të nenit 71, pika 3 të Kodit Zgjedhor, është bërë verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përzgjedhjen në mënyrë rastësore të 5 përqind të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbështetës. Numri i zgjedhësve i verifikuar është 65. Në përfundim të verifikimit, duke përjashtuar dhe nënshkrimet e pa rregullta, numri i dorëzuar është më i madh se numri minimal i kërkuar në bazë të nenit 70, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Referuar ligjit numër 138 të vitit 2015, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, bëhet për çdo kandidat për deputet. Kandidati për deputet z. Kreshnik Merxhani, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 020, datë 08.03.2021. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se ka deklaruar, 2 vendime. Ka qenë i ndaluar nga Komisariati numër 1 Tiranë, për kundravajtje administrative në datën 17.04.2020 dhe pyetjes: A ke jetuar jashtë territorit, i është përgjigjur me po, duke deklaruar se ka jetuar në ishullin Sifinos, për arsye familjare, në gusht të vitit 1996 deri në 1997. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe zyra e Gjendjes Civile. Në përfundim Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pasi ka bërë verifikimin e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet z.Kreshnik Merxhani, ka rezultuar se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë, pra nuk është i dënuar. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga kandidati për deputet, është në përputhje me neni 69,70,73, të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i kërkoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i propozoj, regjistrimin e z.Kreshnik Merxhani, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, për Zonën Zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të

*Zbardhi materialin audio  
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësues të partive politike ose të Komitetit Nismëtar, për regjistrimin e këtij kandidati, kanë diskutime në lidhje me këtë pikë? Jo, nuk kanë! Mirë, atëherë, bazuar në atë çfarë u relatua, si dhe neni 19 pika 1 shkronja n dhe 2, si dhe neni 69,71,72,73, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, udhëzimi numër 1, datë 23.12.2020: Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit dhe të shkronjës a pika 4, të nenit 5 të ligjit numër 138 të vitit 2015: Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, vendos:

1. Të regjistroj z. Kreshnik Luan Merxhani si kandidat për deputet, i propozuar nga zgjedhësit, në Zonën Zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.144**

*Zbardhi materialin audio  
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

**16.03.2021  
Ora 17:37**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqytimin e kërkesës për regjistrimin e z. Boiken Xhelal Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:**      **Y.Merkaj, M.Koja, O. Peto**
- **Parti Politike:**      **PS (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj),  
Kandidat i pavarur (Bojken Abazi)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e 3-të të rendit të ditës.

**Z.Y.Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 16 datë 11.02.2021 ka regjistruar Komitetin Nismëtar për organizimin e mbledhjes së firmave mbeshtetëse për paraqitjen e z. Boiken Xhelal Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet për zonën zgjedhore Qarku Tiranë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në datën 26.02.2021 Komiteti Nismëtar ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nënshkrimet mbeshtetëse të 3744 zgjedhësve, të cilët shprehen se janë përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhor të zonës zgjedhore Qarku Tiranë. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dokumentacioni përkatës. Referuar nenit 69 pika 3 e Kodit Zgjedhor Komiteti mund të regjistroj një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë

**Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI**






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

nënshkrimet për kandidim të një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1% të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore prej jo më shumë se 3 mijë zgjedhësish. Referuar ekstraktit më të fundit të listës zgjedhore rezulton se Qarku Tiranë ka 910 325 zgjedhës. Sipas përcaktimit të pikës së 3-të të nenit 69 të Kodit Zgjedhor numri i zgjedhësve që i korrespondon kufinj të minimal prej 1% të listës është 910 023 zgjedhësish të zonës zgjedhore është 3 mijë zgjedhës. Pasi është bërë verifikimi rezulton se janë depozituar 3744 nënshkrime. Pas verifikimit të nënshkrimeve të dokumentacionit është përzgjedhur numri rastesor i 5% i zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbeshtetës numri i zgjedhësve të verifikuar është 150. Në përfundim të verifikimit rezulton se numri i verifikuar është më i madh se numri minimal i kërkuar për nënshkrimet në bazë të nenit 70, pika 3 e Kodit Zgjedhor. Referuar “Ligjit të Dekriminalizimit” kandidati për deputet z. Boiken Abazi ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 013 datë 26.02.2021. Pas verifikimit të dokumentacionit të verifikimit të formularit të vetëdeklarimit rezulton se z. Boiken Abazi ka deklaruar disa veprime penale të kryera jashtë Republikës të Shqipërisë kryesisht në Kosovë dhe në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion Drejtorisë së Gjendjes Civile dhe Drejtorisë të Gjendjes Gjyqësore ku nga përgjigja e Drejtorisë të Burgjeve rezulton se z. Boiken Abazi është i padënuar dhe nuk ka shëmime në sistem. Duke qenë se veprat që ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit janë jashtë Republikës së Shqipërisë përse i përket kalimeve të pikës 2 nenit 2 për “Ligjin e Dekriminalizimit” veprat penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencë për të kryer verifikime. Në këto kushte i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për një hetim të thelluar. Duke qenë se nuk ka informacion Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kërkon.. dhe nga Prokuroria e Përgjithshme

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

nuk është kthyer ende përgjigje i kërkojm Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të regjistroj z. Boiken Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet në zonën zgjedhore Qarku Tiranë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Pril 2021, faleminderit!


**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike, përfaqësuese të Komiteti Nismëtar për regjistrimin e këtij kandidati diskutime? Jo, nuk kemi. Atëherë, bazuar në çfarë u relatua në lidhje me kërkesën për regjistrimin e këtij kandidati propozuar nga zgjedhësit si edhe neni 19-të, pika 1, shkronja “n” dhe 2, neni 69, 71 , 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor si dhe udhëzimi nr. 1 datë 23.12.2020 për përcakimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit. Si edhe të shkronjës “a” të pikës 4 të neni 5 të ligjit nr. 138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike të ndryshuar”, vendos:

1. Të regjistroj z. Boiken Xhelal Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet në zonën zgjedhore Qarku Tiranë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Saksioneve.

Faleminderit!

**Vendimi nr. 145**

*Zbardhi materialin audio  
Johida SALILLARI*



16.03.2021  
Ora 17:42

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, O. Peto**
- **Parti Politike:**      **PS (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Me vendimin nr. 69 datë 15.02.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruara Partinë Socialiste si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor Partia Socialiste ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore në datë 08.03.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 130 datë 08.03.2021 ka vendosur kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputetë, subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Brenda afatit të përcaktuar Partia Socialiste ka ri depozituar dokumentacionin e korrigjuar. Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka verifikuar listën shumemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe ka konstatuar se është në


Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI



përputhje me nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu kandidatë për deputetë të subjektit politik Partia Socialiste kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit dhe nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit konstatohet se vetëm 3 kandidat kanë deklaruar dënime penale me gjobë dhe të cilat këto deklarime janë konfirmuar dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Duke qenë se referuar deklarimit të kandidatëve dhe përgjigjes së Drejtorisë së Burgjeve vërehet se dënimi me gjobë që parashikohet në nenin 120/2 të Kodit Penal nuk përfshihet në sferën e ndalimit të nenit 2 “Për Ligjin e Dekriminalizimit”. Referuar të dhënave të disponuar kandidatët nuk janë në kushtet e ndalimit për mos zgjedhshmërinë. Referuar “Ligjit të Dekriminalizimit” të dhënat e deklaruara në formulari e vetëdeklarimit nga informacionet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për kandidatët për deputetë të subjektit zgjedhor politik Partia Socialiste nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhshmërinë e tyre të kandidatëve të përzgjedhur për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Pas verifikimit është konstatuar se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimi e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit politik Partia Socialiste për zgjedhjet për Kuvend e datës 25 Prill 2021 për të gjitha zonat zgjedhore, 12 zona zgjedhore. Bashkëlidhur projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si edhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi e Partisë Socialiste ose partive të tjera diskutime në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk kemi. Atëherë, bazuar me sa u relatua në lidhje me dokumentacioni e kandidatit në listën shumemërore të kandidateve për deputetë të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste si dhe bazuar në neni 19-të, pika 1, shkronja “n” dhe 2, si dhe neni 69, 72 , pika 1,

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

2 dhe 73 të Kodit Zgjedhor të Republikës të Shqipërisë si dhe udhëzimi nr. 1 datë 23.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidatit. Si edhe ligjit nr. 138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike të ndryshuar”, vendos:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Sipas lidhjes nr. 1 i bashkëlidhet këtij vendimi për zonat zgjedhore Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastër, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe të Saksioneve.

**Vendimi nr. 146**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

**16.03.2021  
Ora 17:46**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:**      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**      **LSI, PS**

*Z. I. Celibashi:* Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës.

*Z. Y. Merkaj:* Me vendimin nr.70 datë 15.02.2021 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin datë 25 Prill 2021 subjekti politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Në bazë të nenit 67, 72 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore në datën 08.03.2021. Gjithashtu dhe dokumentacionin bashkëlidhur në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve ka verifikuar listat shumemërore të kandidatëve dhe ka konstatuar se janë në përputhje me kërkesat e parashikuara neni 77 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor. Në bazë të ligjit 138 të vitit 2015 të kandidatëve për deputetë, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e deklarimit dhe nga verifikimi konstatojmë se shumica nuk

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

kanë deklaruar si të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimin për ndalim për ligjin 138 të vitit 2015. Nga kandidatët për deputetë të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim vetëm 7 kandidatë kanë deklaruar dënime penale, të cilat nuk përfshihen në fushën e ndalimit si dhe këto dënime penale janë konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Referuar ligjit 138 të vitit 2015, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit nga informacioni i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për kandidatët për deputetë të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim nuk përbën kusht për moszgjidhjen, mosregjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Pas verifikimit të dokumentacionit të kandidatëve për deputetë, konstatohet se është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të neneve të sipërcituara i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e listave shumëme të kandidatëve për deputetë të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, për të 12 qarqet e vendit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit. Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim ka ndonjë gjë? Është dakord. Bazuar në çfarë u relatua në lidhje me këtë kërkesë si dhe neni 19 pika 1, shkronja “n”, dhe pika 2 si dhe neni 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe në Udhëzimin nr.1 datë 23.12.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modelit të kandidimit” si dhe ligjit nr.138 të vitit 2015 “Për garantimin e identitetit të personave që emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 që bashkëlidhet këtij vendimi për zonat zgjedhore Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.147**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*





**16.03.2021  
Ora 17:50**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:**      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**      **LSI, PS**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Referuar nenit 4, paragrafi 4 i vendimit nr.3 të Komisionit Rregullator për kriteret e caktimit, organizimit të vendit të numërimit të votave, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve cakton me vendim vendin e numërimit të votave për çdo zonë të Administrimit Zgjedhor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 12.02.2021, i është drejtuar prefektit të qarqeve për paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të qarkut përkatës. Nga prefekti i qarkut ka marrë propozimet si më poshtë: Prefekti i Qarkut Shkodër në datën 26.02.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 8 objekte sa është dhe numri i Zonave të Administrimit Zgjedhor të Zonës Zgjedhore Qarku Shkodër. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 93, 94, të Kodit Zgjedhor si dhe kanë qenë në vende të numërimit të votave dhe në zgjedhjet e mëparshme. Gjithashtu dhe Prefekti i

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

Qarkut Kukës në datën 26.02.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 3 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës Zgjedhore Qarku Kukës. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 93, 94 të Kodit Zgjedhor dhe kanë qenë edhe në zgjedhjet e mëparshme si vend i numërimit të votave.

Prefekti i Qarkut Lezhë në datën 01.03.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 4 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore të Qarkut Lezhë. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara nenin 93 dhe nenin 94 të Kodit Zgjedhor dhe kanë shërbyer dhe në zgjedhjet e mëparshme si vend të numërimit të votave.

Prefekti i Qarkut Dibër në datën 26.02.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 4 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore të Qarkut Dibër. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 84 të Kodit Zgjedhor dhe kanë shërbyer dhe në zgjedhjet e mëparshme si vend i numërimit të votave. Gjithashtu dhe Prefekti i Qarkut Durrës në datën 08.03.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 6 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara nenin 93 dhe nenin 94 të Kodit Zgjedhor dhe kanë shërbyer dhe në zgjedhjet e mëparshme si vend të numërimit të votave.

Prefekti i Qarkut Tiranë në datën 11.03.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 18 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe kanë qenë edhe në zgjedhjet e mëparshme si vend të numërimit të votave.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021**

Prefekti i Qarkut Elbasan në datën 23.02.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 10 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe kanë shërbyer edhe në zgjedhjet e mëparshme si vend të numërimit të votave.

Prefekti i Qarkut Fier në datën 25.02.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 9 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore të Qarkut Fier. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe kanë shërbyer edhe në zgjedhjet e mëparshme si vend të numërimit të votave.

Prefekti i Qarkut Berat në datën 01.03.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 6, 7 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore të Qarkut Berat. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara nënin 93,94 të Kodit Zgjedhor dhe kanë qenë edhe në zgjedhjet e mëparshme si vend i numërimit të votave.

Prefekti i Qarkut Korçë në datën 09.03.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 7 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara nënin 93,94 të Kodit Zgjedhor dhe kanë shërbyer në zgjedhjet e mëparshme si vend i numërimit të votave.

Gjithashtu Prefekti i Qarkut Gjirokastrë në datën 26.02.2021, ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 7 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe kanë shërbyer në zgjedhjet e mëparshme si vend i numërimit të votave.

**Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

Prefekti i Qarkut Vlorë ka paraqitur listën e objekteve brenda territorit të qarkut ku janë përfshirë 10 objekte sa është numri i zonave të administrimit zgjedhor të zonës zgjedhore Qarku Vlorë. Objektet plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 93,94 të Kodit Zgjedhor dhe kanë shërbyer në zgjedhjet e mëparshme si vend i numërimit të votave. Këto janë 12 qarqe bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e objekteve që do të shërbejnë si vend i numërimit të votave për zgjedhjet e datë 25 Prill 2021.

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësues të partive politike keni ndonjë diskutim? Nuk keni. Bazuar në nenin 19, paragrafi 1 shkronja “n” dhe 2 neni 93 dhe neni 94 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 4 dhe 5 të vendimit të Rregullatorit nr.3 datë 09.02.2021, për kriteret e caktimit, organizimit të vendit të numërimit të votave vendos: të caktojë vendet e numërimit të votave sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.148**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

**16.03.2021  
Ora 17:55**

**RENDI I DITËS**

*Projektudhëzim “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:**      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto.**
- **Parti Politike:**      **PD**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Referuar ligjit të Kodit Zgjedhor të ndryshuar në nenin 96 të paragrafit 2, ku parashikon se për procedurë të hedhjes së shortit për caktimin e partive që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupit të numërimit të votave, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor është përgatitur projektudhëzimi, i cili në përmbatjen e tij ka 8 nene:

Neni 1 përcakton objektin e projektudhëzimit.

Neni 2 përcakton kriteret referuese për partitë politike që marrin pjesë në short, për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të grupit të numërimit.

Neni 3 përcakton veprimet paraprake për organizimin dhe njoftim i hedhjes së shortit mes listës së partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupit të numërimit.

**Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

Neni 4 përcakton procedurën e shortit ku në listën e partive politike që marrin pjesë në short, për caktimin e anëtarit e tretë dhe të katërt apo në listën e partive politike që marrin pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të katërt të grupit të numërimit. Numri i partive politike është 2.

Neni 5 përcakton procedurën e shortit ku në listën e partive politike që marrin pjesë në short, për caktimin e anëtarit e tretë të grupit të numërimit apo në listën e partive politike që marrin pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të katërt të grupit të numërimit. Numri i partive politike është më shumë se 2.

Neni 6 parashikon formimin kalimtar të grupit të numërimit pas këtij udhëzimit dhe sipas përcaktimit të nenit 183 të Kodit Zgjedhor.

Neni 7 parashikon shfuqëzimin e udhëzimit të mëparshëm.

Neni 8 parashikon hyrje në fuqi.

Bashkëlidhur keni projektudhëzimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, përfaqësues të partive politike kanë ndonjë diskutim tjetër në këtë pikë? Nuk ka. Atëherë bazuar në nenin 19, paragrafi 1 shkronja "n" dhe 2 në nenin 96 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, miratoj projektudhëzimin sipas përmbajtjes së propozuar në projektakt.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij akti mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Faleminderit!

**Udhëzimi nr.5**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

**16.03.2021  
Ora 18:03**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për miratimin e 56 gazetarëve nga Televizioni “Syri TV” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:**      **LSI**

**Z.Y.Merkaj:** Televizioni “Syri TV” ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 56 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr.2 të 2021 të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e gazetarëve të Televizionit “Syri TV”, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Në mbështetje të nenit 6, 7 dhe 19 si dhe pikat “1” shkronja “n” dhe pika “2” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe udhëzimi nr.2 datë 02.02.2021 për “Procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare Shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtarë, përfaqësues të shteteve mediave dhe subjekteve zgjedhore” vendos:

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

- 1.Të miratojë kërkesën e Televizionit “Syri Tv” për akreditimin e 56 gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 sipas listës të përcaktuar në lidhjen “1” bashkëlidhur këtij vendimi;
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Pikë tjetër në rendin e ditës nuk kemi. Seanca mbyllet, faleminderit.

**Vendimi nr. 149**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*





**16.03.2021  
Ora 17:57**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë nga koalicioni Reforma për Integrim dhe institucione të konsoliduara “KRIK”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:**      **LSI**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.39 datë 18.12.2020 ka miratuar listën e vëzhguesve afatgjatë nga koalicioni Reforma për Integrim dhe institucione të konsoliduara “KRIK”. Ka miratuar 23 vëzhgues afatgjatë. Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 23 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit. “KRIK” ka vëzhguar si dhe proceset e mëparshme zgjedhore të zhvilluara në vend. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe si i tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve afatgjatë, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

**Z. I. Celibashi:** Në mbështetje të nenit 6, 7 dhe 19 si dhe pikat “1” shkronja “n” dhe pika “2” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe udhëzimi nr.2 datë 02.02.2021 për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat jo qeveritare Shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtarë, përfaqësuar të shteteve mediave dhe subjekteve zgjedhore vendos:

1.Në vendimin nr.39 datë 18.12.2020 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë nga koalicioni për reforma për integrim dhe institucione të konsoliduara “KRIK” për vëzhgimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 të bëhen shtesat si më poshtë:

Në listën e përcaktuar në lidhjen 1 bashkëlidhur vendimin nr.39 të shtohen 23 vëzhgues afatgjatë.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Vendimi nr. 150**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

**16.03.2021  
Ora 17:59**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e 13 vëzhguesve afatgjatë nga Misioni  
“OSBE/ODIHR” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:**      **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:**      **LSI**

**Z.Y.Merkaj:** Misioni i “OSBE/ODIHR” ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 13 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit. “ODIHR” monitoron përmes vëzhguesve zgjedhjet në vend duke pasur parasysh kriteret e lirive themelore, pluralizmit politik, besimin, transparencën dhe përgjegjshmërinë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr.2 të KQZ-së për “Procedurat e hetimit, akreditimit si dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhësve nga organizata joqeveritare të huaja, organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjekteve zgjedhore”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e vëzhguesve afatgjatë, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Në mbështetje të nenit 6, 7 dhe 19 si dhe pikat “1” shkronja “n” dhe pika “2” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe udhëzimi nr.2 datë 02.02.2021 për “Procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

nga organizatat joqeveritare Shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtarë, përfaqësues të shteteve mediave dhe subjekteve zgjedhore” vendos:

1.Të miratojë kërkesën e “OSBE/ODIHR” për akreditimin e 13 vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 sipas listës së përcaktuar në lidhjen “1” bashkëlidhur këtij vendimi;

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Vendimi nr. 151**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

16.03.2021  
Ora 18:00

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për miratimin e 1 gazetari nga Radio Televizioni i Kosovës  
“RTK” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:**      **LSI**

**Z.Y.Merkaj:** Radio Televizioni i Kosovës ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 1 gazetari si dhe zonën e vëzhgimit të tij për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Radio Televizioni i Kosovës është kanal informues i shtrirë në të gjithë Kosovën. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe si i tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e gazetarit të Radio Televizionit të Kosovës, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Një gazetar është, vetëm për një gazetar kan kërkuar akreditimin. Në mbështetje të nenit 6, 7 dhe 19 si dhe pikat “1” shkronja “n” dhe pika “2” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe udhëzimi nr.2 datë 02.02.2021 për “Procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga

**Zbardhi materialin audio**  
**Silvi Sino**



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021***

organizatat joqeveritare Shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtarë, përfaqësues të shteteve mediave dhe subjekteve zgjedhore” vendos:

- 1.Të miratojë kërkesën e “RTK” për akreditimin e 1 gazetari për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021;
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Vendimi nr. 152**

***Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

16.03.2021  
Ora 18:02

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e 48 gazetarëve dhe operatorëve nga Televizioni  
“ABC News” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:**      **LSI**

**Z.Y.Merkaj:** Televizioni “ABC News” ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 48 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Televizioni “ABC-News” është television informativ dhe siguron informacionin konstant të lajmeve nga Vendi, Rajoni dhe Bota. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr.2 të 2021 të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e 48 gazetarëve të Televizionit “ABC News”, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Në mbështetje të nenit 6, 7 dhe 19 si dhe pikat “1” shkronja “n” dhe pika “2” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe udhëzimi nr.2 datë 02.02.2021 për “Procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare Shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtarë, përfaqësues të shteteve mediave dhe subjekteve zgjedhore” vendos:

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.03.2021*

- 1.Të miratojë kërkesën e Televizionit “ABC News” për akreditimin e 48 gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 sipas listës të përcaktuar në lidhjen “1” bashkëlidhur këtij vendimi;
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Vendimi nr. 153**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*

